



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 166

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “LIDHJA DEMOKRISTIANE SHQIPTARE”, ME KRYETAR Z. MHILL GECAJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1208 prot., datë 21.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me kryetar Z. Mhill Gecaj
- OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Lidhja Demokristiane Shqiptare” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Mhill Gecaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 25.2.2025 Nr: 166
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me Kryetar Z. Mhill Gecaj, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 21.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me iniciale “L.D.K”, me Kryetar Z. Mhill Gecaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me shkronja nistore “L.D.K”, me adresë: Rruga "Pjetër Budi", nr.46, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Mhill Gecaj, me adresë: Rruga “Pjetër Budi", nr.46, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Halit Marku, me adresë: Kodër Institut, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Marion Gecaj, me adresë: Rruga “Kastriotët”, nr. 60, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me kryetar Z. Mhill Gecaj, me shkronjat nistore “L.D.K”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI